

**DISA  
TIPARE DALLUESE  
TË  
ISLAMIT**

**Hazret Mirza Tahir Ahmad**

**DISA  
TIPARE DALLUESE  
TË  
ISLAMIT**

Hazrat Mirza Tahir Ahmadi – Imami i Xhematit Ahmadi në Islam, në vitin 1983 i bëri vizitë Australisë. Gjatë qëndrimit të tij në këtë vend, ai mbajti disa ligjërata të rëndësishme. Këtu poshtë po japim përkthimin e një ligjërate të tij që e mbajti në Universitetin e Kanberës të Australisë.

E përktheu:

**Muhammad Zakaria Khan**

## PËRMBAJTJA

Vërtetësia s'është pronë e dikujt.....	1
Religjioni universal.....	4
Diferencat dhe kontradiktat midis feve .....	7
Një religjion i amshueshëm .....	10
Ruajtja e Kur'anit .....	10
Religjioni i përsosur.....	12
Zakati kundër kamatës.....	14
Udhëzimet në çështje politike .....	15
Principet fundamentale të sistemit qeveritare.....	17
Koncepti i drejtësisë në Islam.....	19
Disa tipare të tjera dalluese të Islamit.....	23
Religjioni i paqes .....	28
Lëvizja Ahmadiane.....	29

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ط  
نَحْمَدُهُ وَنُصَلِّي عَلَى رَسُولِهِ الْكَرِيمِ ط

## VËRTETËSIA S'ËSHTË PRONË E DIKUJT

Kur flitet rreth subjektit të tipareve dalluese dhe distingtive të Islamit, tipari i parë dhe më atraktiv që bie në sy, është pohimi i tij i pranueshëm se Islami vërtetësinë nuk e konsideron si pronë të vet dhe as nuk pohon se nuk ka ekzistuar ndonjë fe e vërtetë. Po kështu, ai proklamon haptazi se arabët nuk janë të vetmit, të cilët kanë fituar dashurinë e Zotit.

Islami është ajo fe e vetme që hedh poshtë këtë nocion se vërtetësia është pronë e ndonjë religjioni të veçantë, e as të ndonjë race apo të ndonjë populli. Por, përkundrazi, ai proklamon se hidajeti Hyjnor është dhuratë e përgjithshme dhe bekim i hapët që në të gjitha epokat ia kish dhënë mbështetje humanizmit. Kur'ani i Shenjtë na tregon se nuk ka asnjë racë e as popull që nuk u bekua me dhuratën e hidajetit Hyjnor. Nuk ka asnjë rajon të tokës e as pjesë të ndonjë populli ku nuk kanë ardhur profetët dhe mesazhbartësit e Zotit. Kur'ani thotë.

*"Ti je vetëm një vërejtjedhënës dhe për çdo komb kemi dërguar udhërrëfyes".* (13: 8)

Përkundër kësaj pikëpamjeje botërore të Islamit rreth manifestimit të favorit të Zotit ndaj të gjithë popujve të tokës, na bie në sy fakti se në historinë e njerëzimit nuk ka ndonjë libër të ndonjë fejeje që e verifikon apo bile e përmend mundësinë që popujt e kombeve të tjera kanë marrë dritën e hidajetit prej Zotit. Por, përkundër këtij realiteti, e tërë rëndësia i jepet vërtetësisë së një religjioni lokal a rajonal, kurse vërtetësia e feve të tjera injorohet tërësisht, kjo do të thotë se Zoti i takon vetëm një religjioni të një populli dhe të një race, dhe Ai nuk ka kurrfarë lidhje me njerëzit e tjerë të këtij Universi. Nga kjo del e qartë se dielli i vërtetësisë ka aguar mbi horizontin e kufizuar të një populli të vetëm, ndërsa popujt e tjerë i la në errësirën e amshueshme. P.sh. Bibla e paraqet vetëm Zotin e Izraelit dhe shpesh thotë:

*"Qoftë i bekuar Lordi, Zoti i Izraelit"* (Kronika 16:36)

Ai nuk e verifikon fare realitetin e reformatoreve religjioz të ardhur në ndonjë rajon të ndonjë populli tjetër. Besimi i jehudëve se të gjithë profetët e Izraelit kanë ardhur vetëm për fiset izraelite, është në përputhje të plotë me mësimin e me pëlqimin e Biblës. Po edhe Hazret Isai a.s. (Krishti ) pat deklaruar se qëllimi i ardhjes së tij është vetëm që t'i udhëheqë bijt e Izraelit në rrugë të drejtë. Ai pat thënë:

*"Unë jam i dërguar vetëm për delet e humbura të shtëpisë së Izraelit"* (Ismail 25:32)

Ai edhe besimtarëve të vet ua dha këtë predikim:

*"Mos u jepni qenëve sende të shenjta dhe mos ua gjuani sedefet tuaja thive".* (Mateu 15:21-25)

Në të njëjtën mënyrë edhe Hinduizmi e lidh librin e vet të Shenjtë, Vedën, me njerëzit e shtresës së lartë, siç është shkruar:

"Nëse njeriu i shtresës së ulët ka rast të dëgjojë ndonjë tekst të Vedës, atëherë mbreti i kohës duhet t'ia mbyllë veshët atij njeriu me lakë dhe me plumb të vluar, nëse ai reciton një pjesë të Vedës, duhet t'i prehet gjuha dhe po qe se e lexon tërë Vedën, atëherë duhet që tërë trupi i tij të copëtohet". (Gotama Smiriti:12)

Qoftë ta hedhim posht këtë predikim negativ apo t'ia japin çfarëdo shpjegimi, mbetet fakti se në librat e shenjtë të Hinduizmit nuk përmendet fare, bile as tëthorazi, vërtetësia e feve të tjera të një rajoni apo të një kombi tjetër. Të njëjtën formë dhe të njëjtën pozitë e kanë edhe religjionet e tjera, siç janë Konfushizmi, Budizmi dhe Zaratrustizmi. Asnjë fe prej tyre nuk mohon e as nuk verifikon ekzistencën dhe realitetin e ndonjë religjioni tjetër. Secili prej këtyre religjioneve është i kredhur në vetveten dhe secili prej këtyre religjioneve ka nga një Zot që nuk ka kurrfarë lidhje me krijesa të tjera.

Këtu nënshtrohet pyetja se nëse të gjitha këto fetë kanë qenë, në realitet, të vërteta, atëherë përse koncepti i Zotit u prezentua në një formë të kufizuar? A nuk rezultohet prej kësaj se të gjithë këta libra të shenjtë janë produkt i një diturie të përkufizuar dhe injoranca e tyre ndaj popujve të tjerë paraqet mosdijen e tyre?

Pra, çfarë është ai Zot që e zgjedh vetëm një popull për ta treguar rrugë të drejtë dhe që mbyll sytë prej popujve të tjerë?

Mirëpo, kur e studiojmë dhe e shfletojmë Kur'anin, e gjejmë zgjidhjen e këtyre pyetjeve. Ai thotë se para Kur'anit dhe para ardhjes se Profetit Hazret Muhammedit s.a.s. kanë ardhur

shumë profetë të çdo popull e në çdo rajon të tokës, por megjithatë pozita apo detyra e tyre ishte kombëtare, lokale dhe rajonale. Por edhe zhvillimi i shoqërisë njerëzore nuk kishte arritur në atë nivel të lartë që të vinte ndonjë profet global dhe të sillte mesazhin universal. Kur'ani i përmend profetët lokal e kombëtar, por nuk e përmend profetin universal që ka ardhur para Hazrat Muhammedit s.a.s. e që ka sjellë ndonjë mesazh universal, siç është mesazhi i Islamit.

## **RELIGJIONI UNIVERSAL**

Duke kuptuar mirë këtë çështje ku në një anë zgjidhet një problem kyç dhe në anën tjetër njoftohemi me një karakteristikë tjetër dalluese të Islamit, e cila tregon se Islami është ai religjion i vetëm që u takon të gjithë njerëzve e të gjithë kombeve të botës.

Faqja e parë e Kur'anit e lavdëron atë Zot që është Krijuesi i të gjitha botërave, kurse faqja e fundit na predikon që t'i lutemi këtij Zoti të Universit. Pra, prej fillimit e deri në mbarim të Kur'anit paraqitet koncepti i atij Zoti që është Zot i Universit e jo Zotit të myslimanëve apo vetëm të arabëve. Pa dyshim, nuk ka ekzistuar asnjë profet që ka ardhur për tërë universin e as s'ka pasur para Kur'anit ndonjë libër që i përkiste tërë botës. Për herë të parë u dëgjua kjo jehonë në favor të Hazret Muhammedit s.a.s.

*"Ne s'të kemi dërguar Ty, por si bartës të paralajmërimëve të gëzueshme dhe si alarmues për tërë njerëzimin".*

(34:29)

Mandej Kurani thotë:

*"Thuaju, O njerëz, unë jam profet i dërguar për ju të gjithë".* (7:154)

Po kështu, kur Kur'ani veten e quan "mesazh për tërë botën", ai me këtë tregon dhe deklaron se është ai udhërrëfyes me të cilin është i lidhur ngushtë zhvillimi dhe përparimi i tërë njerëzimit.

Nga ana tjetër, kur studiojmë Librat e Shenjtë të feve të tjera, shohim qartë se nuk vërtetohet univerzaliteti i tyre. Mirëpo, përkundër kësaj, Islami jo vetëm që pohon se është feja univerzale por edhe paraqet argumente të pathyeshme, të cilat në një anë përgënjeshtrojnë pohimin e univerzialitetit të feve të tjera, kurse në anën tjetër paraqesin tiparet dalluese të tij.

Pa dyshim se nuk mjafton për pohim të universalitetit të një religjioni që të besosh në ardhjen e ndonjë profeti apo reformatori në fetë e tjera, por duhet që të besosh edhe në themeluesit e feve të tjera. Këtë atribut nuk mund ta shohim në asnjë fe tjetër, pos Islamit, që e verifikon vërtetësinë e të gjitha feve të botës. Kur'ani gjithashtu veten e quan edhe "verifikues" të Librave të tjerë religjioz dhe sipas Kur'anit të gjithë myslimanët obligohen që të besojnë në profetët e tjerë ashtu siç e besojnë profetin e vet. Sipas Islamit është e ndaluar që një profet ta dallosh nga profetët e tjerë d.m.th. të besosh në një Profet e t'i refuzosh të tjerët. Lidhur me këtë Kur'ani thotë:

*"Ne të gjithë besojmë në Zot, në engjujt e Tij, në Librat e Tij, dhe ne nuk bëjmë kurrfarë ndarje midis profetëve të Tij".* (2:286)



Pra, pa dallim të racës dhe pa dallim të kohës a popullit, apo kombit, besimi në të gjithë profetët e të gjithë popujve dhe respektimi i tyre është ai princip që vë bazën korrekte të pajtimit midis kombeve të ndryshme dhe është rrugë e veçantë e unitetit midis feve. Një besim i tillë, që është kërkesë e madhe për pohimin e universalitetit të ndonjë religjioni, është edhe argument i ndritshëm i universalitetit të Islamit.

Mund të shtrohet pyetja se çfarë atribut është i fshehur në universalitetin dhe pse Islami i jep rëndësi kaq të madhe universalitetit? Lidhur me këte duhet të mbani mend faktin se prejse ka ardhur Islami duke sjellë mesazhin e unitetit të popujve, udhëtimi i botës në drejtim të unitetit të kombeve u bë me hapa të shpejtë. Shembulli i kësaj shpejtësie në kohën tonë shihet qartë në krijimin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe në formimin e federatave të tjera ndërkombëtare. Faktikisht, këto janë gurëkilometrazhi në udhëtimin e gjatë e të vështirë që shpjen drejtë unitetit të plotë midis të gjitha kombeve.

Pra, Kur'ani qysh para 1400 viteve në mesazhin e vet e mbolli farën e zgjidhjes së atyre çështjeve, për të cilat njeriu i civilizuar dhe i përparuar e ndjen një nevojë të madhe. Sot, në të vërtetë, për shkak të zhvillimit të shpejtë të mjeteve të komunikimit, udhëtimi në drejtim të unitetit të kombeve është në vazhdim me gjithë shpejtësinë e vet. Dëshiroj t'ju them haptazi se koha do ta verifikojë këtë të vërtetë, se caku i fundit i këtij udhëtimi është vetëm Islami i cili që nga fillimi pohon se është religjion universal.

## **DIFERENCAT DHE KONTRADIKTAT MIDIS FEVE DHE REALITETI I TYRE**

Paraqitet një pyetje tjetër, nëse të gjithë themeluesit e të gjitha feve kanë qenë prej Zotit, atëherë përse ekzistojnë diferenca midis mësimave e të mesazheve të feve të ndryshme? A është e mundur që një Zot të japë predikime e mësim të ndryshme?

Lidhur me këtë duhet të dini se asnjë fe, pos Islamit, nuk jep përgjigjen e këtyre pyetjeve. Këtu qëndron specifikimi i Sheriatit të Islamit. Ai duke shpjeguar këtë çështje, paraqet dy shkaqe dhe arsye kryesore të diferencimeve midis feve të ndryshme:

1. Se në kohë e në rrethana të ndryshme ka pasur nevojë për mësim të ndryshme. Prandaj, Zoti i Gjithëdijshëm duke respektuar nevojën njerëzore, ka dhënë predikim duke iu përshtatur kohës dhe popujve të vendeve të ndryshme.

2. Arsyja tjetër e diferencës midis feve qëndron në faktin se me kalimin e kohës mesazhi dhe mësimi i feve të mëparshme nuk u ruajt në formën e tyre të vërtetë. Njerëzit, sipas nevojës dhe rrethanave, e ndërronin atë mësim dhe e deformonin, kështu që Librat e shenjtë nuk mbeten në atë formë në të cilën ishin zbritur. Pasi që nuk mbeti asnjë Libër në formë origjinale, u krijua nevoja për një Sheriat të ri. Shkaku tjetër i mos ruajtjes së mësimave të mëparshme është se sa më shumë largoheshin

njerëzit prej kohës së profetizmit, dhe në reaksion kundër përkufizimeve të Sheriatit, aq më shumë u shfaq nocioni për lirinë fetare. Po nga ana tjetër, robëria e dëshirave të poshtëruara ka gjuajtur shtizat e ndërhyrjes në mësimet fetare, e kështu u krijuan plaga të diferencave midis feve. Gjithashtu me kalimin e kohës, një pjesë e këtyre mësimeve është bërë pre e harresës, siç thotë Kur'ani:

*"Ata i ndërronin fjalët nga vendi i tyre dhe një pjesë të atij mësimi e kanë harruar fare".* (5:14)

Pra, kur ne i studiojmë botimet e reja të rishqyrtuara të Biblës, na bie në sy se disa ajete të cilat në botimet e vjetra kanë qenë në përmbajtjen e Librit, tani janë futur në fusnota, kurse ato ajete të cilat kanë qenë në fusnota, janë futur në përmbajtje.

Ky është shembull i vogël. Por, pa dyshim, procesi i ndërrimit e i ndërhyrjes në Tevrat e në Libra të tjerë të shenjtë është në vehte një temë mjaftë e gjerë për të cilën hulumtuesit janë duke punuar prej shekujsh. Nga të gjitha hulumtimet e bëra deri më sot del qartë se u nënvizuan disa ndërrime fundamentale e disa kontradikta, prej të cilave nuk mbyllet syri. Po nëse këtë veprim nuk mund ta quajmë si "tradhti", atëherë vërtetohet fakti se me kalimin e kohës njeriu u detyrua të bëjë ndërrime në Librat e shenjtë.

Islami nuk pohon se të gjitha fetë, në formën e sotme, janë të vërteta. Por, përkundrazi, ai nga fillimi e deri në fund hedh dritë, nga aspektet e ndryshme, mbi ndërrimin, rrënimin, ndërtimin dhe shkatërrimin e vazhdueshëm të tyre. Islami e verifikon vërtetësinë e këtyre feve, por vetëm formën e tyre të zanafillës. Ndërrimi dhe ndërhyrja, dalngadalë e prishi formën e tyre të vërtetë, dhe ky proces i ndërrimit dhe i ndërhyrjes u duk qartë në përmbajtjen, në idetë dhe në dogmat e tyre.

Nëse e studiojmë historinë e diferencave midis feve, nën dritën e principeve të paraqitura nga Kur'ani, na del para nesh ky realitet se sa më thellë të hyjmë në burimin e ndonjë feje aq më shumë zvoglohen diferencat. P.sh. nëse e bëjmë një krahasim midis Krishterizmit e të Islamit, vetëm rreth jetës së Krishtit dhe rreth katër Librave të Unxhillit, atëherë do të shohim se ekziston vetëm një dallim i vogël në mësimet fundamentale të Biblës e të Kur'anit. Por, sa më larg të shkojmë rrugës së kohës, aq më shumë zgjerohet kjo humnerë e diferencave dhe bëhet e pakapërcyeshme. Mirëpo, gjithëkjo u bë për shkak se njeriu e deformoi Mësimin e vërtetë të zbritur prej Zotit.

Poashtu, edhe historia e feve të tjera e verifikon këtë realitet fundamental. Ne në Kur'an gjejmë përkrahje rreth kësaj pikëpamjeje. Është bërë gabim i madh në të kuptuarit dhe të interpretuarit e Mesazhit Hyjnor, kështu që një Zot u shëndrrua në shumë zota dhe realiteti në fikcione sa që në fund "njeriu e bënë Zot".

Kur'ani na tregon se rruga më e sigurtë për ta zbuluar një religjion të vërtetë, me gjithë deformimin e vet, është ta shohim origjinën e tij. Sipas këtij kriteri duhet të studiohet mirë burimi i atij religjioni. Nëse një religjion jep mësim rreth adhurimit të një Zoti të vetëm dhe predikon për bamirësinë dhe për simpatinë ndaj njerëzimit, atëherë një religjion i tillë me të gjitha ndryshimet e bëra në të, duhet pranuar si të vërtetë të Zotit. Ne nuk kemi të drejtë të bëjmë ndonjë dallim në mes tyre. Ata të gjithë kanë pasur tipare të përbashkëta fundamentale, pa marr para sysh se çfarë kohe dhe cilit vend i takonin ata, siç thotë Kur'ani:

وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ ۗ حُنَفَاءَ  
وَيُقِيمُوا الصَّلَاةَ وَيُؤْتُوا الزَّكَاةَ وَذَلِكَ دِينُ الْقَيِّمَةِ ۝ (البينة: 6)

*“Ata nuk u urdhëruan, por vetëm që ta adhurojnë Allahun duke iu bindur singërisht dhe të falen, të paguajn zakatin dhe ky është religjioni i popullit që ecën rrugës së drejtë”.*

(98.6)

## NJË RELIGJION I AMSHUESHËM

Një tipar tjetër dallues i Islamit është se ky jo vetëm që proklamon se është religjion universal, por gjithashtu proklamon se është edhe i amshueshëm. Ai gjithashtu i plotëson kërkesat e shtruara për këtë pohim të tillë. P.sh. Një mesazh mund të jetë i amshueshëm vetëm atëherë kur ai është i përsosur nga të gjitha aspektet dhe gjithashtu duhet të jetë i ruajtur. Kjo do të thotë se Zoti ka dhënë garancion se do të ruhet prej ndërrimeve dhe të ndërhyrjes nga dora e njerëzve.

Me fjalë të tjera, Librat e Shenjtë duhet të kenë një garancion prej Zotit kundër ndërhyrjes njerëzore. Për sa u përket mësimave të Kur'anit, Zoti vetë deklaroi në Kur'an:

*"Sot e përsosa për ju fenë tuaj duke ju dhuruar dhuntinë time të përsosur dhe Islamin e zgjedha për ju si religjion". (5:4)*

## RUAJTJA E KUR'ANIT

Siç thashë më lart se për mesazhin e amshueshëm nuk ka nevojë që vetëm të jetë i përsosur, por duhet që edhe të ketë

garanti se do të ruhet e do të mbetet në formën e tij origjinale. Pa dyshim, Kur'ani është ai Mesazh i vetëm që e plotëson këtë kërkesë fundamentale lidhur me amshueshmërinë e vet. Nga ana tjetër Zoti i cili e zbriti Kur'anin, pohon me fjalë të hapta:

*"Ne e kemi zbritur këtë Libër (Mesazh) dhe ne pa dyshim ne do ta ruajmë".* (15:10)

Pra teksti i Kur'anit është i ruajtur, sepse në çdo epokë janë lindur miliona njerëz të cilët e kanë mësuar përmendësh edhe sot ekzistojnë njerëz të tillë. Nga ana tjetër, Zoti duke dërguar reformatorë në krye të çdo shekulli, e ruajti tekstin dhe esencën e Kur'anit. Poashtu, Zoti lajmëroi rreth ardhjes së një Reformatori të madhërishtëm në epokën e fundit. Këtë reformator Zoti do ta bëjë Imam të kohës, që nën dritën Hyjnore do t'i largojë diferencat dhe kontradiktat e manifestuara në umetin e Hazret Muhammedit s.a.s. dhe kështu do të ruhet realisht shpirti i Kur'anit.

Mirëpo, shtrohet pyetja se a ekziston ndonjë evidencë apo argument që e përkrah dhe e vërteton këtë deklaram të Kur'anit, apo është vetëm një pohim verbal e bosh? Përgjigja e kësaj pyetjeje është e fshehur në faktin se është një numër bukur i madh i hulumtuesve të ndryshëm, të cilët pas një varg përpjekjesh u bindën të pranojnë se prej kohës së Hazrat Muhammedit s.a.s. e gjerë më sot nuk është bërë ndonjë ndryshim në Kur'an. Po edhe shumë studiues jomyslimanë, pas një studimi dhe analize të gjerë, kanë nxjerrë konkludim se Kur'ani është një Libër i pa ndryshuar dhe tërësisht është i ruajtur gjerë më sot. P.sh. Sër Viliam Mejr në librin e tij "Jeta e Muhamedit" shkruan:

*"Ne në bazë të argumenteve të sakta, mund të themi se secili ajet i Kur'anit është në formën e tij origjinale dhe Kur'ani është libri i pandryshuar i Muhamedi".*

(The life of Muhammad f.562)

Mandej shkruan:

*"Pos kësaj kemi edhe çdo Iloj sigurimi, të brendshëm dhe të jashtëm, se librin që e kemi në dorë është ai origjinal, të cilin Muhamedi në kohën e tij ia dhuroi botës"*

(The life of Muhammad, 562).

Një studiues tjetër jomysliman, Holdi, shkruan:

*"Mund të ekzistojë ndonjë gabim shtypi, por Kur'ani, të cilin Osmani - kalif i tretë i Muhamedit ia prezantoi botës, është tekstualisht ai origjinal që e prezantoi Muhamedi. Përpyekjet e bëra nga studiuesit evropianë në hulumtimin e ndryshimeve të bëra në Kur'an shkuan huq"*

(Enciklopedia Britanike, nën fjalën Kuran)

## **RELIGJIONI I PËRSOSUR**

Për sa i përket deklarimit unik e të veçantë të Islamit se Mesazhi i Kur'anit është i përsosur dhe se është në atë pozitë ku ka mundësi që njerëzimit të çdo epoke t'i japë udhërrëfim, mund të themi se pohimi i tillë i Islamit bazohet mbi argumente të pa thyeshme. Mësimi i tij përmban dëshmi të prera subjektive dhe shifet se është i përsosur dhe ka aftësi t'i plotësojë kërkesat e nduarndurta të kohërave të ndryshme.

Është e pa mundur që brenda një kohe të shkurtër të flitet hollësisht rreth tërë subjektit të Mësimimit të Kur'anit.

Mirëpo, sa për ilustrim, po flas shkurtimisht rreth disa principeve udhërrëfyese të këtij mësimi.

Së pari duhet të dijme se si Islami del i sukseshëm në plotësimin e nevojave dhe të kërkesave të kohërave të ndryshme, andaj nuk ka nevojë të krijohet dhe të bëhet ndonjë ndryshim eventual në mësimin e tij. Lidhur me këtë, pa dyshim, është mjaft atraktiv studimi i udhërrëfimit (hidajetit) praktik të Islamit. Lidhur me këtë i paraqes para jush disa shembuj:

1. Islami i paraqet vetëm principet fundamentale dhe shmanget të japë hollësira me qëllim që me ndryshimin e kohërave, të situatave e të rrethanave ato të marrin nuanca të ndryshme kuptimore.

2. Islami kujdeset për evolucionin intelektual, social dhe politik të njeriut, dhe mësimet e tij sillen rreth të gjitha situatave të mundshme. Poashtu, një mësim i tillë bazohet mbi idenë se kurrë në asnjë kohë të gjitha kombet mund të arrijnë nivelin e njejtë të zhvillimit të përgjithshëm. Por, përkundrazi, në çdo kohë ekzistojnë disa popuj të cilët për kah lulëzimi dhe zhvillimi i përgjithshëm u ngjajnë popujve të epokave të ndryshme. Pra, është e mundur që edhe sot në këtë botë të ekzistojnë njerëz të epokës së gurit dhe disa grupe nomade mund t'i takojnë asaj kohe të vjetër njëmijë vjeçare. Mund të ndodhë që ato (grupe nomade) me pozitën e tyre intelektuale, sociale dhe politike, në dukje i takojnë kohës sonë, por në realitet janë të kohës së vjetër. Jam i sigurtë se ne të gjithë do të pajtohemi se do të jetë çmenduri e madhe, nëse i detyrojmë me dhunë banorët origjinal të Australisë dhe Pigmitë e Kongos ta pranojnë ideologjinë moderne politike.

3. Islami është ai religjion që përputhet tërësisht me natyrën e njeriut dhe i plotëson të gjitha nevojat e tij. Nuk ka



nevojë të bëhet ndonjë ndryshim në mësimet e Kur'anit, gjersa të mos paraqitet ndonjë ndryshim fundamental në natyrën e njeriut.

Këto ishin disa fakte të principeve të mësimin të Islamit. Dëshiroj që tani të hedh pak dritë mbi hollësinë e tyre me qëllim që pikëpamja ime të kuptohet më mirë.

## **ZAKATI KUNDËR KAMATËS**

Islami rreptësisht e hedh poshtë kamatën me të gjitha format e saja dhe jep mësimet kategorike për çrrënjosjen e saj totale. Ai në vend të kamatës, për të sjellë rrotën ekonomike, paraqet motivin e zakatit. Mirëpo, është e pamundur që brenda kësaj kohe të pamjaftueshme, të flas detalisht rreth kësaj teme se si është zgjedhur sistemi i zakatit në vend të kamatës? Pra, dëshiroj të them vetëm disa fjalë rreth metodologjisë së adoptuar prej Kur'anit lidhur me paraqitjen e mësimëve të veta në këtë sferë të rëndësishme ekonomike. Zakati është sistem i tatimit ndaj kapitalit, që mirret prej të pasurve. Qëllimi kryesor i zakatit, pos plotësimit të nevojave e të kërkesave të shtetit, është që t'u jepet ndihmë të varfërve dhe të plotësohen nevojat e tyre. Me fjalë të tjera, me anë të zakatit jo vetëm që plotësohen nevojat e shtetit, por plotësohen edhe kërkesat e sigurimit social.

Po të ishte Kur'ani produkt i dorës njerëzore, atëherë, me siguri, njeriu sipas gjendjes së atëhershme të arabve, do të përcaktonte sasinë e zakatit. Mirëpo, megjithëse Kur'ani urdhëron të paguhet zakati, ai nuk e përcakton sasinë e zakatit. Por, në anën tjetër, Kur'ani jep disa udhëzime dhe paraqet disa principe të bazuara sipas të cilave dijetarët e fesë, sipas kohës dhe sipas rrethanave të çdo vendi, mund të marrin ndonjë

vendim të prerë në drejtim të caktimit të sasisë së zakatit. Lidhur me këte Kur'ani thotë se në pasurinë e atyre, të cilët kanë më tepër pasuri se sa u nevojitet për nevojat e tyre, kanë pjesë edhe ata të cilët nuk kanë pasuri për t'i plotësuar nevojat e veta fundamentale. Po nga ana tjetër edhe shteti obligohet që sipas këtij mësimi, të formojë një sistem të drejtë dhe adekuat për të plotësuar qëllimim e tij fundamental.

## **UDHËZIMET NË ÇËSHTJE POLITIKE**

Çështja tjetër ndërkombëtare e kohës sonë me të cilën sot ballafaqohemi është përcaktimi dhe determinacioni i formës së qeverisë së një vendi apo të një rajoni. Poashtu, lidhur me këtë, principet udhëzuese të Islamit janë aq të përshtatshme, të rëndësishme dhe elastike sa që vetë janë bërë evidencë për vërtetësinë dhe përshtatshmërinë e tyre.

Askush nuk mund të mohojë këtë realitet se sisteme të ndryshme qeveritare, në rrethana specifike e sipas kërkesave të veçanta, konsiderohen të përshtatshme apo të papërshtatshme. Kështu një sistem i veçantë i qeverisë nuk mund të jetë i përshtatshëm për të gjitha kohërat e për të gjitha kombet e botës. Për këtë arsye, Islami nuk përcakton ndonjë formë specifike të qeverisë. Ai nuk e prezenton demokracinë e as socializmin, as mbretërinë e as diktaturën. Përkundrazi, Islami në vend të formimit të qeverisë, duke u dhënë rëndësi principeve udhëzuese lidhur me çështjet politike e shtetërore, na këshillon të formojmë çfarëdo forme të qeverisë, por me kusht që obligimet shtetërore të kryhen patjetër në bazë të drejtësisë, të simpatisë njerëzore dhe duke i respektuar ato kërkesa që u përkasin të drejtave fundamentale të njeriut. Pa dyshim, një mësim i tillë është në

përputhje të plotë me natyrën e njeriut. Lirisht mund të numërojmë disa vende të zhvilluara e ato në zhvillim, të cilat sipas natyrës së tyre të veçantë kurrësi nuk mund ta pranojnë demokracinë britanike. Dhe jo vetëm kaq, por nuk është numri i vogël edhe i atyre vendeve evropiane ku eksperimenti i demokracisë nuk korri sukses. Nga ana tjetër, nëse dikund ekziston demokraci, ekziston vetëm në formalitet dhe praktikisht në emër të demokracisë dominon mbi pushtet një byrokraci e fuqishme dhe e organizuar. Islami në vend të segmentit të parë të demokracisë nën emrin "qeveria e popullit" e ngre lart këtë segment me emrin "qeveria për popullin". Prandaj kur në Islam flitet rreth demokracisë, duhet marrë qëndrim në këtë çështje se nuk duhet krijuar demokraci formale, por, përkundrazi, populli të ketë aftësi, mundësi dhe të ketë respekt që sinqerisht dhe drejtësisht t'i zgjedhë ata persona, të cilët realisht janë të aftë ta udhëheqin shtetin. Lidhur me këtë zgjedhje Kur'ani thotë:

إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُكُمْ أَنْ تُؤَدُّوا الْأَمَانَاتِ إِلَىٰ أَهْلِهَا ۚ وَإِذَا حَكَمْتُمْ  
بَيْنَ النَّاسِ أَنْ تَحْكُمُوا بِالْعَدْلِ ط (النِّسَاءُ : 59)

*"Zoti ju urdhëron që kur t'i zgjedhni udhëheqësit tuaj, atëherë i zgjedhni vetëm ata që janë të aftë, dhe kur gjykoni midis njerëzve, gjykoni me drejtësi". (4:59)*

Mandej, çfarëdo qeverie të formohet, ajo obligohet të qeverisë me drejtësi, pa dallim race, ngjyre, religjioni dhe kombi. Mund të shohim, jashtë këtij mësimi, se ka disa qeveri, të cilat u formuan në emër të demokracisë dhe që i shkelin të drejtat njerëzore më shumë se sa në mbretëri apo në diktaturë. Pra, secili sistem dhe çdo udhëheqës, qoft mbret apo diktator apo disa persona që në emër të demokracisë i mbajnë në dorë

frenat e qeverisë, duhet të formojnë ndonjë kushtetutë që u përputhet udhëzimeve të Kur'anit. Vetëm ajo qeveri që formohet brenda suazave dhe principeve të Sheriatit - Kur'anit, do të jetë e aftë t'i plotësojë të gjitha nevojat dhe kërkesat normale të njeriut.

## **PRINCIPET FUNDAMENTALE TË SISTEMIT QEVERTAR**

Tani do të paraqes shkurtimisht disa principe të dhëna prej Kur'anit dhe që kanë të bëjnë me çfarëdo sistem qeveritar:

1. Çdo qeveri ka obligim të ruajë nderin, jetën, dhe pasurinë e popullit.
2. Çdo sundues detyrohet të sillet me drejtësi ndaj individëve dhe ndaj tërë shoqërisë.
3. Problemet kombëtare duhet të zgjidhen me marrëveshje.
4. Qeveria duhet t'ua sigurojë njerëzve nevojat themelore - banim, ushqim dhe veshëmbathje.
5. Qeveria duhet të obligohet që të krijojë një ambient paqësor për të ruajtur nderin, jetën dhe pasurinë e personave.
6. Duhet të rregullohet sistemi ekonomik.
7. Qeveria duhet të kujdeset rreth shëndetit të popullit.
8. Duhet të aplikojë liri të plotë fetare.
9. Duhet të sillet në mënyrë të drejtë ndaj popullit të pushtuar.
10. Robërit e luftës duhet të sillen mirë e të trajtohen mirë.
11. Marrëveshtjet dhe deklaratat duhet gjithmonë të respektohen.
12. Ndaj palës së dobët nuk duhet prishur marrëveshja me forcë.

13. Çdo mysliman është i obliguar të dëgjojë dhe të respektojë qeverinë e atij vendi ku jeton. Përrjashtim ka vetëm kur qeveria i kundërshton brutalisht rregullat e Islamit.
14. Nëse ndërmjet udhëheqësve krijohen mospajtime, ato duhet të zgjidhen dhe të sqarohen nën dritën e principeve të paraqitura prej Kur'anit dhe prej Hazret Muhammedit s.a.s. Askush nuk ka të drejtë t'i ndjekë motivet e veta personale.
15. Populli urdhërohet të bashkëpunojë me qeverinë dhe të asistojë në planifikime për punë të dobishme. Ai ndalohet të marrë pjesë në lëvizje jokooperative. Poashtu, edhe qeveria duhet të asistojë kur populli paraqet kërkesa për punë pozitive. Ajo nuk duhet të krijojë pengesa për popullin në kryerjen e punëve të tilla, qoftë në sektorin individual apo në sektorin shoqëror.
16. Shtetit të fortë i ndalohen të gjitha format e agresionit kundër ndonjë shteti tjetër. Çdo shtet ka të drejtë të përdorë forcën vetëm në vetëmbrojtje.

Vërejni se sa i plotë dhe nga çdo aspekt është i përkryer ky mësim i Islamit. Nëse Islami urdhëron për formimin e një sistemi të caktuar, atëherë lind pyetja se si mund të zbatohet një sistem i tillë aty ku ai nuk mund të përshkujë, dhe si mund të jetë i përshtatshëm një sistemi i tillë, kur në këtë botë të zhvilluar, sipas shpejtësisë së evolucionit shoqëror e ekonomik të vendeve e të kombeve të ndryshme, ekzistojnë kombe e civilizime të ndryshme, dhe njeriu i sotëm megjithëse jeton në një epokë, por në realitat ai u takon epokave të ndryshme? A është e mundur që disa popuj të pacivilizuar të Australisë dhe të Afrikës të barazohen me ata të Britanisë së Madhe apo me ata të

Amerikës në nivelin e tyre ushtarak, ekonomik dhe social? Një sistem i tillë a mund t'ua sjellë satisfakcion të gjithëve? Jo. Kurrsesi. Sistemi i prezentuar prej Islamit është pikërisht sipas natyrës njerëzore dhe që është larg kufive të kohës e të vendit.

## **KONCEPTI I DREJTËSISË NË ISLAM**

Në lidhje me përsosmërinë dhe amshueshmërinë e fesë Islame, në Kur'an i gjejmë disa mësimë të tjera që janë të pandryshueshme dhe të cilat nuk mund t'i ndërrojnë as rrethanat e as koha. Tani po citoj disa shembuj të principeve të Islamit për të cilat bota e sotme e ndjen një nevojë të madhe.

Shembulli i parë i mësimëve të Islamit është në lidhje me drejtësinë dhe me barazinë. Mirëpo për të kuptuar mirë realitetin, lartësinë dhe madhësitinë e këtij mësimi, duhet që pak a shumë të flitet rreth këtij mësimi të drejtësisë e të barazimit të prezentuar prej feve të ndryshme, me qëllim që në procesin historik të zhvillimit shoqëror të caktohet e të sqarohet pozita adekuate e mësimi të drejtësisë Islamike.

Kur hedhim një shikim mbi religjione të ndryshme, shihet qartë realiteti se mësimi i drejtësisë dhe i barazisë nuk shihet fare në ato religjione, dhe nëse e gjejmë dikund, atëherë shifet qartë se njeriu i sotëm nuk është në gjendje ta pranojë atë për shkak të papërshtatshmërisë së atij mësimi. Përkundrazi, disa pjesë të tij janë aq shumë në konflikt direkt me intelektin dhe me ndjenjat e njeriut të kohës sonë, sa që ai detyrohet të konkludojë se një mësim i tillë, ndoshta me kalimin e kohës është deformuar, apo ishte për një rreth të vogël dhe i përkohshëm. P.sh. feja çifute e prezenton Zotin si Zot vetëm të Izraelit duke e përjashtuar tërë njerëzimin. Prandaj, një mësim i

tillë nuk përputhet fare me kërkesën fundamentale të të Drejtave Njerëzore. Ashtu është edhe nocioni i drejtësisë që ekziston në formë të kufizuar në Hinduizëm dhe sipas të cilit shihet qartë armiqësia e tyre jo vetëm ndaj popujve të tjerë por ndaj hindusëve të shtresave të ulëta dhe kështu mëshirën e Zotit e ngushtojnë dhe e zvogëlojnë për njerëz të tjerë. P.sh. Hinduizmi predikon:

*"Nëse një Brahman ka marrë borxh prej një njeriu të shtresës së ulët dhe ai s'mund t'ia kthejë borxhin, atëherë borxhëdhënësi s'ka të drejtë të kërkojë kthimin e borxhit. Por nëse njeriu i shtresës së ulët nuk është në gjendje t'ia kthejë borxhin Brahmanit, ai detyrohet të punojë për të derisa të mos ia lajë tërë borxhin"* (Manu Smriti, 10:35).

Edhe një herë them se në fenë jahude nuk ekziston nocioni i drejtësisë ndaj armiqve. Shifni se ç'thotë Tevratit:

*"Kur Lordi, Zoti yt, i dorëzon armiqt në duart tuaja, therini dhe mos bëni ndonjë marrëveshje me ta dhe nuk duhet të keni mëshirë ndaj tyre".*

Tani për të bërë një krahasim, po prezentoj disa shembuj të mësimt të Islamit rreth drejtësisë dhe të barazisë që i përfshinë të gjitha fushat e veprimtarisë dhe të jetës njerëzore. Pra Kur'ani thotë:

1. "Kur të gjykoni midis njerëzve, gjykoni me drejtësi". (4:59)
2. "Çdo dëshmi e juaj duhet të jetë vetëm për hir të Zotit e në emër të drejtësisë, qoftë me anë të dëshmisë suaj të pësojë dëm vetë qenia juaj, prindërit apo të afërmit tuaj" (4:136)

3. "Armiqësia e as një kombi nuk duhet t'ju ngacmojë që të mos gjykoni me drejtësi. Ju patjetër duhet ta mbani drejtësinë se ajo është më afër rrugës së drejtë". (5:9)
4. "Luftoni në rrugën e Zotit vetëm kundër atyre, të cilët kanë filluar luftë kundër jush. Dhe mos e teproni se Zoti nuk i do ata që e teprojnë". (2:91)
5. "Nëse armiqt shtrijnë dorën e pajtimit, respektojeni dëshirën e tyre dhe shtrini edhe ju dorën e pajtimit". (8.62)

Shembulli tjetër i mësimet të pandryshueshëm të Islamit është në lidhje me hakmarrjen dhe me faljen. Kur në këtë lëmi i krahasojmë mësimet e Islamit me ato të feve tjera, atëherë predikimi i poshtëshënuar i Biblës tingëllon çuditshëm në veshët e njeriut të sotëm:

*"Syri yt të mos ketë mëshirë, sepse jeta është për jetë, syri për sy, dhëmbi për dhëmbë, dora për dorë dhe këmba për këmbë"*  
(Ekzodosi 21:24)

Njeriu i sotëm pikëllohet e habitet, kur sheh një qëndrim të tillë rreth hakmarrjes. Megjithëse, këtë shembull nuk e paraqita me qëllim që të kritikoj, përkundrazi, do të orvatem të sqaroj se, nën dritën e mësimet të Kur'anit, ne mund të justifikojmë këtë mësim që në dukje është mjaft i vrazhdët dhe i ashpër. Këtu Kur'anit na mëson dhe na ndihmon duke na dhënë principe të ndryshme e të thella që t'i kuptojmë mësimet e tilla e jo vetëm t'i hedhim poshtë duke i kritikuar ashpër. Pa dyshim, edhe ky është një atribut i Kur'anit. Pra, sipas Kur'anit, ky mësim mbi hakmarrjen është i lidhur ngushtë me nevojën specifike të një epoke të veçantë. Filozofia e këtij mësimi të hakmarrjes qëndron në faktin se duke jetuar vazhdimisht nën



prangat e robërisë e duke u bërë viktime të tiranisë, Izraelitë ishin bërë frikacakë dhe nuk ishin në gjendje t'i ruanin të drejtat e veta ligjore. Ata ishin bërë pre të kompleksit të inferioritetit.

Pra, është qartë se një mësim i tillë u është dhënë vetëm që t'u jepet zemër dhe stimulim. Nuk ishte e udhës që në një situatë të tillë t'u jepej një mësim faljeje. Po të ngjante kështu, atëherë ai komb që ishte i shkelur dhe i shtypur dhe që frikohej të marrte hak, do të mbështjellte friken e vet nën çarçafin e faljes dhe do t'i lante duart nga cilësitë burrërore, siç ishte dikur. Pra, sipas Kur'anit, një mësim i tillë në atë situatë që i përshtatshëm dhe në përputhje të plotë me rrethanat e asaj kohe dhe, pa dyshim një mësim i tillë u është dhënë nga Zoti i Gjithëdijshëm e i Plotëfuqishëm.

Në anën tjetër, kur studiojmë Testamentin e Ri, shohim shumë kontradikta në të. Këtu i jepet forcë aq shumë faljes sa që bijtë e Izraelit e humbën tërësisht të drejtën e hakmarrjes.

Arsyeja e kësaj qëndron në faktin se duke vepruar për një kohë të gjatë, sipas këtij mësimi të hakmarrjes, çifutët ishin bërë zemërgurë e gjakpirës dhe kjo sëmundje mund të shërohej vetëm kur të ndërprehej e drejta e hakmarrjes. Prandaj, Jesu Krishti për këtë arsye ua dhe këtë predikim:

*"Keni dëgjuar që është thënë më parë: syri për sy dhe dhëmbi për dhëmbë, por unë ju them të mos bëni rezistencë kundër shtypësit, por, përkundrazi, ai që të japë shuplakë në njerën faqe, ktheja faqen tjetër dhe ai që don ta xhveshë pallton tënde, jepja edhe këmishen".*

*(Mateu5:35-45)*

Pa dyshim, se ajo ishte kohë kur njeriu në fillim të procesit të edukimit e të zhvillimit ende nuk kishte arritur në

pjekurinë e tij. Pra, mësimi i asaj kohe nuk mund të jetë i përshtatshëm e as bile i pranueshëm për njerium e pjekur të kohës së sotme.

Ne besojmë se Islami është ligji final që prezenton një mësim i cili nuk pëson kurrfarë ndikim nga vendi e as nga koha dhe ky fakt mund të ilustrohet nga mësimi i Kur'anit, siç është:

وَجَزَاءُ سَيِّئَةٍ سَيِّئَةٌ مِّثْلُهَا ۚ فَمَنْ عَفَا وَأَصْلَحَ فَأَجْرُهُ  
عَلَى اللَّهِ ۗ إِنَّهُ لَا يُحِبُّ الظَّالِمِينَ (الشورى: 41)

*"Mbani mend se shpërblimi i dëmit është aq sa është dëmi,  
por ai që fal fajtorin dhe pajtohet, ai merr shpërblim prej  
Zotit. Zoti nuk i do ata që sillen mizorisht e tiranisht"*

(42:41)

Me të vërtetë, Islami i bashkon të dy tiparet e bukura të predikimeve të mëparshme me një shtesë se falja është më e mirë vetëm me kusht që fajtori të përmirësojë veten. Përndryshe, dënimi është i nevojshëm, por nuk duhet tepruar. Pra ky është ai mësim që përputhet tërësisht sipas natyrës së njeriut dhe mund të praktikohet edhe sot, siç ishte në praktikë para 14 shekujve.

## **DISA TIPARE TË TJERA DALLUESE TË ISAMIT**

Përmbajtja e tipareve dalluese të Islamit është mjaftë e gjerë. Këto ishin vetëm disa aspekte të rëndësishme, të cilat i zgjodha për këtë ligjëratë. Koha nuk më lejon të flas hollësisht rreth të gjitha aspekteve të mësimave të Islamit, mirëpo i nënvizoj shkurtimisht disa aspekte të tjera të Islamit.

1. Islami e paraqet Zotin si kreator të Universit dhe tregon se ai është Një dhe ky pohim paraqitet në formë të thjeshtë e të kuptueshme, të cilën njësojë mund ta kuptojë lehtë edhe njeriu i padijshëm dhe ai i dijshtëm. Islami tregon se Zoti është Qenia perfekte, është burim kryesor i të gjitha attributeve dhe është larg prej të gjitha të metave. Ai është Zot i Gjallë dhe kudo e manifeston Vetën, i do krijesat e Veta dhe i dëgjon thirrjet dhe lutjet e tyre. As një atribut i Tij kurrë nuk ndërprehet e këputet. Pra, Ai edhe sot komunikon me njerëzit e vet, siç komunikonte në kohën e lashtë dhe muk e mbyll atë rrugë që e çon njeriun drejt pragut të Tij.
2. Islami pohon se nuk ekziston kontradikta midis Fjalës së Zotit e të veprës së Tij. Kështu Islami e liron njeriun nga konfliktet tradicionale midis shkencës e religjionit dhe nuk jep mësim që njeriu të besojë në diçka që është jashtë ligjeve të natyrës. Ai na udhëzon të studiojmë natyrën dhe të fitojmë dobi prej saj, sepse çdo gjë e krijuar, është krijuar për dobinë e njeriut.
3. Islami nuk e bind njeriun me dhunë të pranojë diçka por e paraqet çdo gjë me arsyetim e me argumente të prera, të cilat i japin satisfakcion mendjes së njeriut dhe shpirtit të tij i japin thellësi të pakufishme.
4. Islami nuk bazohet mbi mite e mbi fikcione. Ai e fton çdo kënd të bëjë eksperimente dhe tregon se çdo realitet mund të verifikohet në forma të ndryshme.
5. Sheriati i Islamit është unik që dallohet prej të gjithë Librave të të gjitha feve. Opozitarët e tij, përkundër të

gjitha përpjekjeve të përbashkëta të bëra shekuj me radhë, nuk mundën të krijojnë një pjesë të ngjashme me Kur'anin. Ky libër nuk është unik vetëm letrarisht, por edhe për shkak të mësimave të veta të thjeshta e të thella. Kur'ani edhe vetë pohon se është Mësimi më i mirë dhe një pohim i tillë nuk dëgjohet prej asnjë libri tjetër Hyjnor.

6. Kur'ani pohon se ai është kombinimi i mësimave të Librave të mëparshëm dhe të gjitha realitetet e thella të mësimave të Librave të vjetër ekzistojnë në Kur'an. Kur'ani thotë:

*"Ky përfshin edhe atë që është dhënë në Librat Hjnorë të kaluar -Librat e Ibrahimit e të Musait"* (87:20)

7. Tipar tjetër dallues i Islamit është se Libri i tij Hyjnor është në gjuhën e gjallë. A nuk është i çuditshëm fakti se gjuhët e Librave të tjerë hyjnorë janë të vdekura ose përgjithësisht nuk përdoren fare? Gjuha e gjallë e Kur'anit dëshmon dhe argumenton jetën e tij.
8. Tipari tjetër i Islamit është se profeti i tij ka kaluar nëpër të gjitha fazat e jetës dhe ka përjetuar të gjitha situatat imagjinative të eksperiencës njerëzore, duke filluar nga fëmijëria e tij bonjake dhe e varfër e deri në sundim e mbretëri. Jeta e tij dokumentare në çdo hap e në çdo kthesë krijoi shembuj të ndritshëm dhe shprehu një dashuri e një besim pashoq ndaj Zotit dhe bëri sakrifica të pandërprera në rrugën e Tij. Ai ka pasur një jetë plotë ndodhi dhe plot rreziqe kështu që la pas vetes një shembull perfekt në të gjitha sferat e përpjekjeve njerëzore. Pa dyshim, cilësitë e tilla janë të domosdoshme për

- shembullin perfekt. Profeti i Islamit në vete ishte interpretim i gjallë i Kur'anit dhe me modelin personal e ndriçoi rrugën e njerëzimit të të gjitha kohërave. Asnjë profet tjetër nuk ka luajtur një rol të tillë.
9. Tipar tjetër dallues i Islamit janë profecitë e tij, të cilat duke u plotësuar në çdo kohë e përforcojnë besimin e njerëzve ndaj ekzistencës së Zotit e ndaj vërtetësisë së Islamit. Ky proces edhe sot është në vazhdim, siç dëshmon kufoma e ruajtur e Faraonit, i cili i dëboi Hazret Musain a.s. dhe besimtarët e tij nga Egjipti. Një shembull tjetër i freskët, nga paralajmërimi i Kur'anit, është krijimi i mjeteve të reja shkatërruese. Këto mjete janë në formë zjarri që është i mbyllur në një grimcë të imët dhe që para eksplodimit zgjatet e tundet me egersi e që i shndërron bjeshkët në avull.
  10. Tipar tjetër dallues i Islamit është se kur ai flet rreth botës së paskësajme dhe rreth jetës pas vdekjes, jep paralajmërimet të lidhura në këtë botë që duke u plotësuar krijojnë besim të fortë ndaj jetës së ardhëshme.
  11. Islami dallohet prej feve të tjera edhe në prezentimin e mësimin të drejtësisë e të barazisë individuale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Këto udhëzime janë aq të përshtatshme e të zgjeruara sa që e përfshijnë çdo situatë imagjinative, dhe jep udhëzime të pranueshme dhe adekuate lidhur me rregullimin e marrdhënieve në mes të rinjve dhe pleqve, midis punëtorëve dhe punëdhënësve, në mes të anëtarëve të familjes dhe shokëve dhe armiqve. Principet dhe udhëzimet e tilla janë me të vërtetë universale dhe të pandryshueshme.

12. Islami garanton barazinë e plotë midis njerëzve pa dallim race, feje, dhe ngjyre. Pra, sipas tij të gjithë njerëzit janë të barabartë. Islami paraqet një kriter të ri e të veçantë për të dalluar njeriun prej njerëzve të tjerë dhe ai kriter është bamirësia, dëlirësia dhe zemërbardhësia e njeriut, siç Kur'ani thotë:

إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَى (ط (خَم: 14))

*"Keni të qartë se njeriu më i respektueshëm midis jush, në sy të Zotit, është ai që është më i dëlirë në mesin tuaj".* (49:14)

Mandej thotë:

وَمَنْ عَمِلَ صَالِحًا مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ أُنْثَىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَأُولَٰئِكَ يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ يُرْزَقُونَ فِيهَا بِغَيْرِ حِسَابٍ (المؤمن: 41)

*"Ai që bën të mirën, qoftë prej meshkujve apo prej femrave, dhe është besimtar, të tillët do të hyjnë në Parajsë ku do të dhurohen pahesap" (40:41)*

13. Islami paraqet një përkufizim të bamirësisë e të mëkatit që e veçon atë prej të gjitha feve. Islami dëshirat natyrore të njeriut nuk i konsideron mëkat, por sipas tij, përdorimi i tyre pavend është mëkat. Islami na mëson që dëshirat tona natyrore të rregullohen e të drejtohen në mënyrë që të jenë të dobishme dhe konstruktive për shoqërinë në përgjithësi.
14. Islami është një religjion unik që femrën e bëri jo vetëm trashëgimëtare në pasuri, por ia dha edhe të drejtat e barabarta me mashkullin. Ai megjithëse krijoi barazi në

mes të mashkullit dhe femrës, prapëseprapë kësaj çështjeje nuk i dha aq shumë forcë që të eliminohet diferenca krijuese e qenies së mashkullit e të femrës.

## **RELIGJIONI I PAQES**

Në fund këtë lajm të gëzueshëm u jap të gjithë individëve dhe kombeve që dëshirojnë paqën, se Islami është ai religjion i vetëm i cili sot garanton paqen individuale, shoqërore, sociale, ekomomike, kombëtare dhe ndëkombëtare. Mësimi i tij i paqes i përfshin të gjitha këto sektorë të jetës. Islami është religjioni unik që në emrin e vet e mban kuptimin e paqes. Njeriu që pranon fenë Islame quhet mysliman që do të thotë "hyrësi në paqë" jo vetë por duke u dhënë edhe të tjerëve paqe dhe duke u larguar prej çdo veprë që krijon çrregullime. Vërejni se sa bukur ka thënë profeti i Islamit:

*"Se myslimani i vërtetë është ai nga fjala e nga vepra e të cilit nuk trazohen e nuk shqetësohen të tjerët".*

*(Bukhari, Kitabul Iman)*

Po kështu, profeti i Shenjtë, para vdekjes së vet, me rastin e Haxhillëkut përcjellës, dha një ligjëratë të shkurtër e të rëndësishme që është një kushtetutë e amshueshme e paqës për tërë njerëzimin.

Islami nuk krijon paqen vetëm midis njerëzve, por edhe në mes të njeriut dhe Zotit. Sipas kësaj, mysliman do të quhet ai i cili nuk i trazon të tjerët as me anë të fjalës e as me anë të veprës dhe nga ana tjetër, ruhet vetëm nga dënimi e nga hidhërimi i Zotit që manifestohet si rezultat i mëkatit. Pra, fjala mysliman përmban në vete kuptimin e gjerë të paqes e të rehatisë. Pa dyshim, mësimet e Islamit, poqëse kombet e botës

veprojnë sipas tyre, kanë aftësi t'i shpëtojnë konfliktit dhe shkatërrimit.

Islami është religjion i gjallë dhe pohon se mund të krijojë marrëdhënie në mes të njeriut e të Zotit, siç shihen marrëdhënie të tilla në kohën e lashtë. Ai nuk e konsideron "diktimin" dhe "komunikimin me Zotin" si mitet dhe fikcionet e kohës së kaluar, por përkundrazi, i jep lajm të gëzueshëm çdo njeriu të çdo kohe se rrugët e bekimit shpirtëror, me anën e të cilave Hazret Nuhi a.s. dhe Hazret Isai a.s. kanë fituar takimin e Zotit e më së miri profeti i Islamit ka pasur një takim të tillë, janë ende të hapura dhe e thërrasin atë që dëshiron takimin e Zotit.

## **LËVIZJA AHMEDIANE**

Xhemati Ahmadi në Islam beson se ky pohim i Islamit u plotësua në kohën e sotme me qenien e themeluesit të këtij Xhemati - Hazrat Mirza Gulam Ahmadit a.s. i cili u lind në vitin 1835 në Kadijan - një fshat i panjohur i Indisë. Ai duke ecur rrugës së bamirësisë e të dëlirësisë dhe duke i përcjellë besnikërisht mësimet e Islamit u shpërblye me komunikimin e Zotit. Mori diktimin hyjnor që bazohet mbi profecitë e tija të shumta, të cilat u plotësuan në jetën e tij dhe po plotësohen edhe sot.

Hazrat Mirza Ghulam Ahmadi nën udhëzimin Hyjnor e themeloi Xhematin Ahmadi në vitin 1889. Ai vdiq në vitin 1908 duke lënë pas vetes një komunitet të përbërë nga miliona njerëz aktivë në përhapjen e fesë Islame. Misioni i tij është në vazhdim me anë të kalifave të zgjedhur.



Themeluesi i Xhematit Ahmadia duke e paraqitur qëllimin e ardhjes së tij, thotë:

*"Unë jam dërguar që të vërtetoj se Islami është i vetmi religjion i cili është i gjallë. Unë u bekova me fuqitë shpirtërore para të cilave të gjithë njerëzit e feve të tjera dhe ata që shpirtërisht janë të verbër, janë të dorëzuar. Unë mund t'i demonstroj çdo kundërshtari se Kur'ani për kah mësimet e tij, përkah dituria e vet e shëndritshme, përkah mendjehollësia e tij të thellë dhe delikate dhe përkah elokuenca perfekte e tij është një mrekulli, që është qindra herë më e madhe se sa mrekullitë e Hazret Musait e të Hazret Isait".* (Anxhame Atem, f. 46)

Ai vazhdon

*"Unë jam dritë në errësirën e kësaj kohe. Ai që më ndjek mua do të shpëtojë nga hendeqet dhe pengesat e tjera që shejtani i përgatiti për ata që ecin në errësirë. Mua më dërgoi Ai (Zoti) që ta udhëhëq botën me paqe e me butësi në drejtim të Zotit të vërtetë dhe të stabilizoj moralet e Islamit. Unë jam i bekuar me shenjën qiellore që t'ua jap satisfakcion ndjekësve të vërtetësisë".*

(Masih Hindustam Me, f. 13)

Tani, e përfundoj ligjëratën time duke cituar një pjesë nga shkrimet e themeluesit të Xhematit Ahmadia që është apel për tërë njerëzimin:

*"Pasqyra me anën e së cilës shihet ajo Qenie e Lartë, është komunikimi i Zotit me njeriun. Le të ngrehet në këmbë e të kërkojë ai, zemra e të cilit shqetësohet për vërtetësinë. Unë ju them të vërtetën se nëse shpirti kërkon*

*sinqerisht dhe zemra ndien etje për vërtetësi, atëherë njerëzit duhet të gjejnë metodën dhe rrugën e drejtë. Por si do të hapet kjo rrugë dhe si do të ngritet kjo perde? U garantoj të gjithë kërkimtarëve se vetëm Islami jep lajme të gëzueshme në këtë rrugë. Sepse të gjitha fetë e tjera ka herë e kanë vulosur diktimin dhe komunikimin e Zotit. Duhet të dini se kjo vulosje nuk është vënë prej Zotit, por është rezultat i dëshpërimit të vetë njeriut. Pa dyshim, siç është e pamundur të shohim pa sy, të dëgjojmë pa veshë e të flasim pa gjuhë, ashtu është e pamundur që pa ndihmën e Kur'anit të shohim atributet e të Dashurit Zot. Kam qenë i ri dhe tani jam plakur, por nuk kam gjetur askënd që pa pasur këtë burim të pastër, e piu kupën e vetëdijes së çiltër". (Filozofia e Mësimeve të Islamit. f.131-132)*

Pa dyshim, kjo ftesë është mesazh jetëdhënës për secilin shpirt që kërkon vërtetësinë reale.

**DISA TIPARE DALLUESE TË  
ISLAMIT**

*Some Distinctive Features of Islam*

*Albanian Translation*

An address delivered by Hazrat Mirza Tahir Ahmad  
Khalifatul Masih IV, Head of the worldwide  
Ahmadiyya Jamaat in Islam at the Australian  
National University (A. N. U.) Canberra. Australia.

ISBN 1 85372 122 0

